

KONTRATE DHURIMI TE KUOTAVE TE SHOQERISE

Sot, ne Tiranë, me datë 23.09.2021 kjo kontrate dhurimi nenshkruhet nga palet e meposhtme:

Znj. Arisa Bidaj, shtetase Shqiptare, lindur me 09.07.1990 ne Tirane, banuese ne Tirane, mbajtese e Leternjoftimit ID me Nr. 032138542 dhe nr. Personal J05709055W me zotesi te plote ligjore per te vepruar (qe me poshte do te quhet "Dhuruesi") DHE

Z. Saimir Bidaj, shtetas Shqiptare, lindur me 10.12.1965 ne Tirane, banues ne Tirane, mbajtes i Leternjoftimit ID me Nr. 035673580 dhe nr. Personal G51210051U me zotesi te plote ligjore per te vepruar (qe me poshte do te quhet "Pranuesi i Dhurimit")

Dhuruesi dhe Pranuesi i Dhurimit do të referohen bashkërisht si "**Palët**".

DEKLARIME PARAPRAKE

- Dhuruesi eshte ortake i shoqerise tregtare **DERMAL AESTHETICS ALBANIA SHPK**, me Nr. NIPT: **L821100100** (ketu e meposhte referuar si "**Shoqeria**").
- Dhuruesi eshte pronar i nje kuote me vlere **33,33%** te kapitalit te shoqerise.

Neni 1

Objekti i Kontrates

- 1.1 Ne baze dhe per zbatim te nenit 13.2 te Statutit te shoqerise, Dhuruesi trasferon nëpërmjet dhurimit kuoten e tij e cila ka vleren e 33,33% te kapitalit te shoqerise, tek Pranuesi i Dhurimit. Pranuesi i Dhurimit Z. Saimir eshte babai (paraardhesi) i Dhuresit Znj. Arisa **Pas ketij dhurimi ortaku Z. Saimir Bidaj behet zoterues i nje kuote me vlere 33,33% te kapitalit.**
- 1.2 Pranuesi i Dhurimit deklarone se pranon dhurimin e kuotave të Shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate.
- 1.3 Transferimi nëpërmjet dhurimit do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndryshuar, "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*".

Neni 2

Transferimi pa shpërblim

- 2.1 Transferimi i kuotave sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit do të kryhet pa shpërblim.

Neni 3

Kalimi i Pronesisë

- 3.1 Me daten e nënshkrimit të kësaj kontrate, Pranuesi i Dhurimit bëhet zotërues i kuotave të dhuruara të shoqërisë, duke u bërë titullar i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me to, përfshirë ushtrimin e te drejtes se votes, pjesmarrjen në mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme dhe ne fitimet e Shoqërisë, sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë.
- 3.2 Kuotat e të drejtat e fituara si më sipër si dhe vlefshmeria e kalimit te titullit te pronesise mbi kuotat nuk do te kushtezohet nga krerja e formaliteteve te ndryshme me efekt deklarativ, perfshire ketu formalitet e regjistrimit ose te publikimit te kontrates apo te kalimit te titullit sipas percaktimit ne piken 2 te nenit 73 te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtare dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar.

Neni 4

Garancite

- 4.1 Dhuruesi deklarone dhe garantone Pranuesin e Dhurimit kuotat janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë, hipotekë apo çdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 5
Forca Madhore

- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfardolloy dispozite vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohet për shkak të forcave madhore dhe në mënyrë të vecantë për shkaqet si, revolucione, çrregullime, lëvizje popullore, luftra, greva, zjarre, përmytje, tërmete, fenomene të natyrës, shtetëzime, shpronësime, ose akte të pushtetit qëndror apo lokal që kufizojnë lirinë personale apo të sipërmarrjes.

Neni 6
Interpretimi i Kontrates ne teresi

- 6.1 Çdo kusht apo formulim qe mund te sjelle paqartesi do te interpretohet ne kontekstin e teresise se Kontrates dhe brenda qellimit qe i beri Palet te nenshkruajne kete Kontrate.

Neni 7
Legjislacioni i zbatueshem dhe juridiksioni

- 7.1 Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve te Kodit Civil i Republikes së Shqipërisë si dhe ligje, dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektine kësaj kontrate.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrveshjeve

- 8.1 Palët bien dakort që çdo mosmarrveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast se bisedimet nuk do të japin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles se Pare Tiranë Shqiperi.

Neni 15
Ndryshimet

- 15.1 Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj Kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe të firmoset nga Palët.

Neni 16
Hyrja ne fuqi

- 16.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.

Neni 17
Gjuha e kontrates

- 17.1 Kontrata perpilohet ne 4 kopje te njejta ne gjuhen Shqipe.

PALET

DHURUESI
Z. Arisa Bidaj

Arise Bidaj


PRANUESI I DHURIMIT
Z. Saimir Bidaj

Saimir Bidaj
